



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 38, datë 28.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TURISTIK SAN PIETRO, KOMUNA ISHËM,
QARKU DURRËS”**


Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Concord Investment” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Ndërtimi i kompleksit turistik San Pietro, Komuna Ishëm, Qarku Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Concord Investment” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 28.02.2020, nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

E DI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLËSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

